



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 479/2 prot

Datë 27.02.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Pepa Group” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-91765-12-20-2023, me objekt “*Rikonstruksioni i godines se anatomisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*”, me fond limit 80,128,758.52 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Pepa Group” SHPK me NIPT (L42215009L), me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km.6, Rruga dytësore “Iliria”, Kashar, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Universiteti i Mjekësisë Tiranë, me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005, Tiranë

Në datën 27.02.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 479 protokolli, datë 27.02.2024 e operatorit ekonomik “Pepa Group” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-91765-12-20-2023, me objekt “*Rikonstruksioni i godines se anatomisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*”, me fond limit 80,128,758.52 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Pepa Group” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Pepa Group” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 479 protokollit, datë 27.02.2024. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

Operatori ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k. me NUIS: L42215009L nuk përmbush kriteret si më poshtë:

1. Për pikën 2.3.1 /b vlerësimi i përvojës së suksesshme për kontratat e realizuara me ente publike operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor, konkretisht puna është nënkontraktuar e gjitha tek operatori ekonomik “Trema Engineering 2” sh.p.k., i cili më pas ka nënkontraktuar një pjesë të punimeve tek operatori ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k. Nga Autoriteti Kontraktor Ujësjiellësi Kanalizime Kamëz sh.a. nuk ka asnjë miratim lidhur me nënkontraktimin e operatorit ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k. për kryerjen e kësaj pjese të punimeve si dhe në kontratën bazë të nënkontraktimit midis “Trema Engineering 2” sh.p.k. dhe “STRABAG AG” nuk ka asnjë pikë lidhur me lejimin e nënkontraktimit.

- Nuk është paraqitur akti i kolaudimit, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” ku citohet se: “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t’i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik...” ku në nenin 3 specifikohet: “Në kuptim të këtij ligji, nëse nuk përcaktohet ndryshe punime ndërtimi quhen të gjitha punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale, të infrastrukturës dhe për objektet e tjera.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 27.02.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri